

ASETET

KAPACITETI

BESIMI

Ejani dhe ju të Punoni!

Shumë organizata janë bashkuar për të krijuar një aleancë të mbështetësve të filantropisë komunitare për t'ju përgjigjur këtyre pyetjeve dhe për të forcuar fushën e veprimit. Ata ju ftojnë që të bashkoheni me ta.

Për informacion të mëtejshëm në lidhje me aleancën, ju lutemi kontaktoni:

Natalie Ross

Natalie.Ross@akdn.org

www.akdn.org/AKF

Nick Deychakiësky

nick@mott.org

www.mott.org

Për informacion të mëtejshëm në lidhje me filantropinë komunitare, ju lutemi kontaktoni:

Jenny Hodgson

jenny@globalfundcf.org

www.globalfundcommunityfoundations.org



AGA KHAN FOUNDATION USA
1825 K Street NW, Suite 901
Washington, D.C. 20006
www.akdn.org
info.akfusa@akdn.org
+1.202.293.2537




CHARLES STEWART MOTT FOUNDATION
Mott Foundation Building
503 S. Saginaw Street, Suite 1200
Flint, MI 48502
www.mott.org info@mott.org
+1.810.238.5651



GLOBAL FUND FOR COMMUNITY FOUNDATIONS
Fourth Floor, 158 Jan Smuts Avenue Rosebank
Johannesburg 2196 South Africa
www.globalfundcommunityfoundations.org
info@globalfundcf.org
+27.11.447.4396



Rockefeller Brothers Fund
Philanthropy for an Interdependent World
475 Riverside Drive, Suite 900
New York, NY 10115
www.rbf.org
communications@rbf.org
+1.212.812.4200



Që nga Kenia në Indi dhe më tej në Sllovakia e Brazil banorët vetë kanë përmirësuar shkollat, kanë krijuar punësim, kanë fuqizuar qytetarët, organizatat dhe kanë mobilizuar donatorët.

Si e kanë arritë këto komunitete një gjë të tillë?


Ata i janë drejtuar filantropisë komunitare.

MODELI I FILANTROPISË KOMUNITARE
si Shembull i Formësimit
të Vlerave Lokale,
Aftësisë dhe Besimit

Pse Është e Rëndësishme

Praktika Vendore, që po Përhapen në Gjithë Botën

Në Sllovaki, Fondacioni i Qytetit Banská Bystrica është i pari fondacion komunitar në Evropën Lindore. Ndonëse, fillimet e veta i pati nëpërmjet projektit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, për Qytete të Shëndetshme, ky fondacion tashmë ka një grup donatorësh vendorë dhe e ka orientuar strategjinë e vet tek iniciativat e udhëhequra prej qytetarëve. Fondacioni mbështet grupet të cilat ndihmojnë fëmijët e rrugëve të qytetit, ka ndihmuar në krijimin e organizatave që ndihmojnë komunitetin e romëve vendas, ka ndihmuar në vënien në përdorim të një Banke të Rinjsh me qëllim përfshirjen e banorëve të rinj në filantropi dhe në atë që drejtoresha ekzekutive Beata Hirt, njëherë e quajti si suksesin më të madh, pra “u ka treguar qytetarëve vendas, se ata kanë energji dhe aftësi të mjaftueshme për t’i zgjidhur vetë problemet.”



Në Brazil, Instituti Komunitar Grande Florianópolis, ose ICom, u krijua nga aktivistë vendas për të përfunduar organizatat e brishta me bazë në komunitet. Puna e ICom-it është e mrekullueshme për shumë arsye. Ata mobilizojnë donatorët vendorë që të investojnë në zhvillimet komunitare. Ata krijojnë hartën e pasurive komunitare dhe e orientojnë vëmendjen tek çështjet lokale. Njëherazi ata promovojnë përdorimin novator të teknologjisë për të mirën e shoqërisë. Dhe janë po ata aktivistë vendas që po e vënë në funksion konceptin e fondacionit komunitar në Brazil. “Ne kemi mësuar, që së pari kemi nevojë, të nxisim një kulturë të dhënies sistematike,” thotë Anderson Giovanni da Silva, drejtori ekzekutiv i ICom-it. “Më pas, ne sigurojmë mjetet e nevojshme të cilat u ndihmojnë organizatave komunitare, donatorëve individualë, kompanive dhe qeverisë, që të punojnë së bashku.”

Në Kenia, një organizatë e quajtur Shoqata e Zhvillimit Komunitar Makutano (MCDA) ka një listë të gjatë arritjesh, duke përfshirë ndërtimin e nëntë digave dhe 17 puseve dhe zhvillimin e 10,000 hektarëve toke pjellore. Ndërkohë që këto rezultate janë mbresëlënëse, ajo çka e veçon këtë organizatë, është aftësia e kësaj të fundit për të rritur aftësitë e banorëve që këta më pas ti kontrollojnë vetë zhvillimet e tyre. Raphael Masika, një drejtues vendas, i cili ishte një faktor i rëndësishëm në krijimin e MCDA-së, e shpjegon përkushtimin e organizatës për të ndërtuar kapacitete afatgjata komunitetesh, në këtë mënyrë: “Njerëzit në Kenia nuk janë të varfër, sepse nuk kanë burime të nevojshme, por sepse nuk kanë njohuri, se si ti përdorin burimet e tyre.”


Në Indi, më shumë se 5,000 banorë nëpër 50 fshatra u bashkuan si anëtarë të Fondacionit Prayatna. Në zbatim të parimit: “pronësi vendorë për probleme vendorë,” ata mobilizuan banorë, shumica Dalit dhe Myslimanë, që të kontribuonin me kohë, ushqim, mjete financiare dhe burimet të tjera në mënyrë, që të përkrahin me sukses të drejtat e njeriut, të drejtën për strehim, punësim, llogaridhënie të qeverisë, dhe për drejtësi sociale. Organizata ka zhvilluar aftësitë e drejtuesve vendorë, ka farkëtuar lidhjet midis komunitetit Hindu dhe atij Mysliman si dhe ka promovuar fuqinë e veprimeve të përbashkëta. “Kur ne shkojmë vetëm, ata nuk na dëgjojnë, - thotë një anëtar, - por kur shkojmë së bashku, ata gjithmonë na dëgjojnë.”

Për informacion të mëtejshëm mbi punën në Kenia dhe shumë të tjera, ju lutemi vizitoni Fondin Global për Fondacionet e Komunitetit në www.globalfundcommunityfoundations.org.

Një Zgjidhje në Horizont!

Në gjithë botën, qytetarët po e sjellin praktikën e filantropisë¹ komunitare në jetë në çdo mënyrë të mundshme. Ata po krijojnë dhe qeverisin organizata të reja të cilat grumbullojnë dhe vënë në dispozicion të ardhura vendore dhe pasuri të tjera. Ata po i përshtatin programet në varësi të nevojave të komunitetit dhe po rrisin ndërgjegjësimin rreth çështjeve vendore. Ata po bashkojnë drejtuesit e komunitetit, po fuqizojnë shoqëritë civile dhe po planifikojnë për të ardhmen afatgjatë.

Organizatave të filantropisë komunitare po shumëfishohen. Midis viteve 2000 dhe 2010, një lloj fondacioni - fondacionet komunitare—u përhapën në mënyrë të mrekullueshme me 86%, mesatarisht 70 institute të krijuara çdo vit.² Janë përmendur një numër faktorësh për të shpjeguar këtë rritje, duke përfshirë organizatat që mbështesin zhvillimin e përvojës, një model organizimi fleksibil, financim afatgjatë dhe zgjerim i përpjekjeve për të ndërtuar një shoqëri civile në gjithë botën.



Ndërkohë që fondacionet komunitare janë forma më e përhapur e filantropisë komunitare, lloje të reja të organizatave po i shtojnë më tej kufijtë e kësaj përvoje. “Gjatë viteve të fundit ka patur një valë të re të organizatave filantropike komunitare,” thotë Halima Mahomed nga TrustAfrica. “Ato janë organike, të rrënjëzuara në kontekst, nuk janë të lidhura me një koncept të caktuar dhe nuk kopjojnë modelet e bamirësisë komunitare të ndonjë tjetri.”

Në thelb, filantropia komunitare nxit dëshirën e popullatës vendore për të ndihmuar njëri-tjetrin, një pasuri që ndodh natyrshëm dhe që gjendet në të gjitha shoqëritë dhe kulturat. Me të vërtetë, shumë praktikues e përqasin përvojën me një impuls bashkësie, një lloj si të ishte një formë organizative.

Duke patur parasysh, se filantropia komunitare ka aftësi të veçanta ta orientojë atë impuls drejtë rritjes se jetëgjatësisë së institucioneve vendore dhe ka fleksibilitetin për t’ju përshtatur rrethanave vendore dhe ti përshtatur donatorëve vendorë, rrit interesin e komuniteteve ndaj per tu përfshirë.

“Vihet re një ndryshim në lidhje me atë, se si filantropia komunitare praktikohet në vendet në zhvillim. Ajo po i largohet modelit të Amerikës Veriore, model i cili përqendrohet kryesisht në nevojat e donatorëve. Filantropia komunitare në vendet në zhvillim është shumë më fleksibile. RISIA po vjen nga Afrika, Azia dhe Amerika Latine.”

AVILA KILMURRAY, FONDACIONI KOMUNITAR PËR IRLANDËN VERIORE

¹ Siç përkrahjet në *Vlera e Filantropisë Komunitare*, një sërë diskutimesh përgjatë 2010-2011 midis praktikuesve dhe financuesve cuan në zhvillim e një “përkufizimi në bazë të karakteristikave” të filantropisë komunitare, duke specifikuar mes tjerash faktin, se “është e organizuar dhe strukturuar,” “është e vetë-drejtuar,” “funksionon si arkitekturë e hapur,” “ndërtën shoqëri civile,” “përdor të ardhura dhe pasuri vendore” dhe “kërkon një shoqëri përfshirëse dhe të barabartë.” Ky raporti i cili është komisionuar nga Fondacioni Aga Khan SHBA, Fondacioni Charles Stewart Mott dhe shkruar nga Barry Knight, mund të gjendet në vegzën: <http://www.mott.org/files/publications/thevalueofcommunityphilanthropy.pdf>.

² Shikoni *Raportin e vitit 2010 të Statusit Botëror mbi Fondacionet Komunitare*, të përgatitur nga Iniciativat Mbarë-botërore për Përkrahje të Organizatave Donatore (WINGS).

Logjika e Filantropisë Komunitare

Komunitetet po kthehen tek filantropia komunitare pjesërisht, se kjo praktikë çon në rezultate (përmbarime) të mira të zhvillimit. Sipas Jenny Hodgson të Fondit Botëror për Fondacionet Komunitare, një logjikë e fuqishme qëndron prapa konceptit të filantropisë komunitare, një grup hipotezash të tipit “nëse/atëherë”, se si mund të krijojë rezultate të cilat janë të rëndësishme për banorët, financuesit dhe praktikuesit:

- Nëse njerëzit e ndiejnë, se ata janë bashkë-investues në vetë-zhvillimin e tyre, atëherë ata janë më të interesuar në rezultatet (përmbarimet) që pasojnë.
- Nëse banorët sjellin asetet e tyre në tavolinën e diskutimeve, atëherë dinamikat e fuqisë janë më të barabarta, në sensin e formimit të një partneriteti, jo thjesht një marrëdhënie tradicionale donator-përfitues.
- Nëse qytetar vendorë udhëheqin dhe kontribuojnë në filantropinë komunitare, atëherë përfituesit vendorë duhet të jenë përgjegjës në mënyra që të sigurojnë ndërtimin e kapitalit shoqërorë.
- Nëse institucionet filantropike komunitare mund të veprojnë si depo e llojeve të ndryshme të besimit dhe pasurive, atëherë ato mund ta drejtojnë zhvillimin në mënyra efektive.

Praktikuesit dhe mbështetësit e filantropisë komunitare kanë përcaktuar tri shtyllat themelore të kësaj praktike:

ASETET - VLËRAT

Filantropia komunitare ndërton dhe shpërndan pasuritë vendore - financiare dhe të tjera. Kjo është arsyeja pse donatorët individualë dhe institucionalë e konsiderojnë atë një udhë efektive drejt qëndrueshmëri, për rritjen e një baze burimesh për punën në çështjet e komunitetit. Përdorimi i pasurive vendore, përfshirja e donatorëve vendorë dhe përdorimi i rregullt i ndihmave të përhershme - të gjitha këto i mundësojnë filantropisë komunitare që ta forcojë shoqërinë civile gjatë një periudhe afatgjatë.

KAPACITETI

Organizatave filantropike komunitare zhvillojnë kapacitete afatgjata në formën e marrëdhënieve, njohurive, infrastrukturës dhe drejtuesve kyç për shoqërinë civile— kapacitete këto të cilat nuk mund të arrihen me qasje afatshkurtra. Në veçanti, filantropia komunitare është një mënyrë efektive për të forcuar zërat dhe pjesëmarrjen e qytetarëve. Kjo formë është në një pozicion mjaft të përshtatshëm për të ndihmuar organizatat që t’u përshtaten ndryshimeve të kushteve, përparësive të reja vendore, zhvendosjes së interesave të donatorëve dhe mundësive për drejtim.

BESIMI

Nëpërmjet qeverisjes së ngritur brenda vendit dhe vendimeve transparente të financimit, filantropia komunitare ndërton besimin e qytetarëve në institucionet e tyre vendore dhe te njëri-tjetri. Kapitali shoqëror i forcon shoqëritë civile. Ndez shkëndijën e pjesëmarrjes. Krijon një ndjenjë të pronësisë vendore të procesit të zhvillimit. I lejon organizatat filantropike komunitare të transmetojnë, informojnë dhe mobilizojnë me efektshmëri qytetarët në mënyra që organizatat e tjera nuk kanë mundësi ta bëjnë.

Rruga drejt Rezultateve të Mira



Një Thirrje për Veprim

Një numër përherë në rritje financuesish, praktikuesish dhe përkrahësish kanë filluar të studiojnë mënyra për të forcuar dhe rritur në rang botëror filantropinë komunitare si një strategji zhvillimi, praktikë filantropike dhe forcë komunitare.

Për të rritur shtrirjen dhe ndikimin e saj si një praktikë efektive zhvillimi, filantropia komunitare kërkon mbështetje. Një mbështetje e tillë duhet të bazohet në nevojat e komunitetit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë asaj çka po ndodh në terren dhe nuk duhet të drejtohet nga programe të jashtme.

Thirrja për mbështetje përkrahet nga hulumtimi. Për shembull, *Raporti i Statusit Botëror i vitit 2010 mbi Fondacionet Komunitare* i WINGS gjeti se treguesi më i mirë i rritjeve të reja në fondacionet komunitare midis 2008 dhe 2010 ishte prania e organizatave kombëtare dhe rajonale të cilat mbështetën zhvillimin e këtyre fondacioneve në fillim të dekadës.

Gjithashtu, ky koncept përkrahet nga ndjesia për mundësi të reja. Filantropia komunitare ka treguar se është efektive dhe e besueshme shtrirë në një kontekst të larmishëm gjeografik dhe kulturor. Ka ardhur koha ta ndihmojmë që të bëhet një strategji gjithëpërfshirëse zhvillimi. Ndërkohë që teknologjia e bën më të lehtë për donatorët e jashtëm t'ju japin të holla komuniteteve të largëta, organizatat filantropike vendore janë të nevojshme për t'i modeluar dhe për t'i kanalizuar këto investime. Duke marrë parasysh faktin që kjo praktikë është gati për tu përmirësuar dhe rritur, tani është momenti për t'u hedhur në veprim.

Si Mund ta Ndhimojmë Praktikën që të Lulëzojë?

Mbështetësit po studiojnë një numër pyetjesh ndërkohë që zhvillojnë strategji rritjeje:

- Si mund të sigurojmë më shumë mundësi për bashkëpunim dy palësh dhe shkëmbim njohurish midis praktikuesve të filantropisë komunitare?
- Si mund ta çojmë më tej kuptimin e praktikës me anë të hulumtimit, vlerësimit dhe komunikimeve?
- Cilat janë rrugët më efektive për t'i ndihmuar organizatat filantropike komunitare që të krijojnë një pikëmbështetjeje?
- Si mund ta mbështesin financuesit e jashtëm filantropinë komunitare ndërkohë që ulin dinamikën e “ndikimit nga jashtë-brenda” i cili mund të ndikojë negativisht në përpjekje të tilla?
- Çfarë lloj infrastrukture ndërkombëtare mund të financojë eksperimentet, të zhvillojë mjetet, të grumbullojë fondet, të hartojë asetet, të mbledhë drejtuesit, të krijojë rrjete bashkëpunimi dhe të forcojë praktikatat?
- Si mund të ndërtojmë një lëvizje botërore për filantropinë komunitare?

“Ne kemi punuar në shoqëritë civile për një kohë të gjatë. Kur njerëzit i bëjnë gjërat vetë këto programe kanë qenë më të **QËNDRUESHMET**. Udhëheqësit, financimi, burimet dhe mbështetja vullnetare janë të gjitha të qëndrueshme.”

MIRZA JAHANI, FONDACIONI AGA KHAN

“Në disa vende mënyra e vetme për të patur një ndërhyrje efektive është që njerëzit të **BASHKOHEN** së bashku. Ne kemi nevojë për një mënyrë ku komunitetet mund të aktivizohen e mobilizohen dhe të bashkohen së bashku.”

TADE AKIN AINA, KORPORATA CARNEGIE

“Nuk është e lehtë për financuesit e jashtëm të cilët investojnë shumë para dhe presin që programet të jenë të qëndrueshme. Nga përvoja jonë, puna vazhdon, kur ju e keni mbështetur filantropinë komunitare. Kjo praktikë **FUNKSIONON**.”

SHANNON LAWDER, FONDACIONI C.S. MOTT

“Filantropia komunitare lë vend për eksperimente. Ne jemi të vegjël, por **FLEKSIBEL**. Ne mund t'i mbushim hapësirat boshe. E gjitha ka të bëjë me eksperimentimin dhe të qenit ndërmarrës.”

JAN DESPIEGELAERE, FONDACIONI KOMUNITAR WEST-FLANDERSWEST-FLANDERS

“Ne mbështetemi tek shpatullat e individëve të cilët **KOMUNITETI** i njeh dhe i beson.”

FELENCIA JONES, FONDACIONI KOMUNITAR BLACK BELT

“Hap pas hapi ne po bëhemi një burim i informacionit dhe **NJOHURISË** mbi komunitetin.”

LÚCIA DELLAGNELO, INSTITUTI KOMUNITAR GRANDE FLORIANOPOLIS

“Ne donim ta **TRANSFORMONIM** komunitetin brenda për brenda.”

MARWA EL DALY, FONDACIONI KOMUNITAR WAQFEYAT AL MAADI

“Ne po luftojmë me bindjen se vetëm ndërtimi i një pusi nuk është i mjaftueshëm, pasi ky nuk është zhvillim. **ZHVILLIMI**, po thonim, është historia që fshihet pas pusit...A ka ndërtuar aftësi vendore? A i ndryshuat zakonet? A e nxite komunitetin, që të mendojë ndryshe?”

MONICA MUTUKU, ISH-ANËTARE E FONDACIONIT TË ZHVILLIMIT KOMUNITAR TË KENIAS

“Nëpërmjet filantropisë komunitare, **AKTORË VENDORË** mund të zotërojnë zhvillimet e tyre.”

MARYANNE YERKES, AGJENSIA E SHBA-SË PËR ZHVILLIMIN NDERKOMBËTAR